

AKT THEMELIMI
DHE
STATUT
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Rose Belle” SH.P.K

Sot më datë 18/02/2025, i nënshkruari:

- Zj.Fiona Ruli,e bija e Vahid dhe Alueta, e datëlindjes 08/12/1990, lindur në Tirane, banues në Tirane , dhe mbajtës i kartës së identitetit me nr.**J06208033U**;

Vendosi të themelojë shoqërinë me përgjegjesi të kufizuar “**Rose Belle**” sh.p.k, në bazë të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe ligje të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe për këtë arsye hartoi statutin e kësaj shoqërie.

KREU I
THEMELIMI, EMRI, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1
Emri dhe themeluesit

1.1 Shoqëria “**Rose Belle**” sh.p.k, është person juridik i së drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

1.2 Themeluesi i Shoqërisë është:

Zj.Fiona Ruli,e bija e Vahid dhe Alueta, e datëlindjes 08/12/1990, lindur në Tirane, banues në Tirane , dhe mbajtës i kartës së identitetit me nr.J06208033U;

Neni 2
Objekti

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është tregti import-eksport dhe shitje me shumice dhe pakice të artikujve të ndryshëm industrial.



Neni 3 **Selia**

3.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Nacionale Tiranë – Elbasan, Farkë, Lundër, Zona kadastrale 2529, vol 12, fq. 193, nr pasurie 863/4-N225, Qendra tregtare TEG, kati I pare, njesia B019+B019a.

3.2 Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është: f.ruli@hotmail.com.

Neni 4 **Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.

KREU II **KAPITALI I SHOQËRISË (ZMADHIMI, ZVOGËLIMI, TRANSFERIMI)**

Neni 5 **Kapitali themeltar**

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është **10.000 Lekë**.

5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë është **10.000 lekë**, i ndarë në 1 *kuotë* të mbajtur nga ortaku i Vetëm i shoqërisë si në vijim:

- Ortaku themelues: zj. Fiona Ruli, zotëruesi 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme **10.000 lekë**, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6 **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

- 6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet e derdhura nga ortaku, sipas procedurave ligjore të parashikuara në këtë rast.
- 6.2 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakut të vetëm, e cila merr vendime në bazë të përcaktimeve në ligj dhe në statut.

Neni 7 **Transferimi i kuotave**

- 7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.



KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi vendimmarrës

- 8.1 Asambleja e ortakut të vetëm është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.2 Duke qënë se shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i tretë ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.
- 8.3 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një person i tretë. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakut në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9
Thirrja e asamblesë së përgjithshme

- 9.1 Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, nga ligje të tjera ose sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
- 9.2 Asambleja e përgjithshme mund të thirret nga administratori ose nga ortaku i vetëm i saj.

Neni 10
Administrimi

- 10.1 Shoqëria administrohet nga të paktën 1 (një) administrator dhe maksimumi 3 (tre) Administratorë, të cilët qëndrojnë në detyrë deri në revokim, dorëheqje apo mbarim të afatit të emërimit.
- 10.2 Administrimi i shoqërisë bëhet nga administratori në përputhje me kompetencat, të drejtat dhe detyrimet që i jep ligji përgjegjës për shoqëritë tregtare, statuti, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe rregullat e brendshme të administrimit të shoqërisë.
- 10.3 Administrator i shoqërisë është:
Zj.Fiona Ruli, e bija e Vahid dhe Alueta, e datëlindjes 08/12/1990, lindur në Tirane, banues në Tirane , dhe mbajtës i kartës së identitetit me nr.J06208033U dhe me speciment nënshkrimi bashkëlidhur.
- 10.4 Administratori do të ushtrojë kompetencat e tij për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë riemërimi. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.
- 10.5 Administratorët mund të emërojnë përfaqësues të posaçëm për akte të veçanta ose për kategori aktesh.

Neni 11
Kompetencat e Administratorit

- 11.1 Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:
- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

- e) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 11.2 Administratori është i detyruar të thërrasi Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Neni 12

Përgjegjësitë e Administratorit

- 12.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 12.2 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, administratori detyrohet:
- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 12.3 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 12.4 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.
- 12.5 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakut ka të drejtë të ngrejë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 13

Viti financiar

- 13.1 Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjatë vitit, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.
- 13.2 Bilancet vjetore, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar, nëse është emëruar, miratohen nga Asambleja me shumicën e përcaktuar sipas ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 13.3 Miratimi i dokumenteve që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 muajve nga fundi i vitit financiar.

Neni 14

Fitimet

- 14.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% të destinuara për rezervën ligjore deri në 10% të kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumatat që Asambleja vendos të vërë mënjane, i shpërndahen ortakut.
- 14.2 Asambleja mund të vendosë dhe zbritje të vecanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo për shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

Neni 15

Ekspertët

- 15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e ortakut të vetëm, kontrolli i pasqyrave financiare dhe librave kontabël të shoqërisë mund t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar.
- 15.2 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakut.
- 15.3 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.
- 15.4 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

KREU V
PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 16
Prishja dhe likuidimi

- 16.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të Asamblese së Ortakut;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”;
 - d) me vendim të gjykatës;
- 16.2 Në këtë rast ortaku i vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikohet mënyra e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.
- 16.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortaku. Nëse ortaku nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 17
Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Asamblesë së ortakut të vetëm, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin përkatës për shoqëritë tregtare.

Neni 18
Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit përkatës për shoqëritë tregtare, ligjit përkatës për regjistrimin e biznesit; ligjit përkatës për qendrën e biznesit, Kodit Civil, ligjit nr.8901, ligjit përkatës për falimentimin; si dhe çdo ligj tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 19
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe te tretëve, në rast se ato nuk zgjidhen me mirëkuptim, për shqyrtimin e tyre do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 20
Gjuha

Ky akt dhe themelimi dhe statut është i shkruar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

Lexuar, gjetur konform vullnetit të lirë e të pavesuar, pranuar dhe nënshkruar nga ortakut themelues:

ORTAKU I VETËM
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Rose Belle” SH.P.K

Zj.Fiona Ruli

